

RNR në Ballkanin Perëndimor

PUNIMI PËRFUNDIMTAR

Punëtori rajonale në shkallë të vogël e RNR në Ballkanin Perëndimor

16 qershor 2022, Online

Radikalizimi online dhe qasjet ndaj P/KEDH në Ballkanin Perëndimor

Rezultatet kryesore

Përparimet teknologjike kanë hapur kanale të reja për organizatat ekstremiste që të përhapin mesazhet e tyre dhe të fitojnë mbështetje për qëllimet e tyre politike. Kjo tendencë vërehet edhe në Ballkanin Perëndimor (BP). Përveçse e bëjnë më të thjeshtë për individët komunikimin me njëri-tjetrin, platformat e mediave sociale e kanë bërë më të lehtë për zërat urrejtës që t'i përhapin pikëpamjet ekstremiste. Organizatat ekstremiste e kanë përvetësuar shumë mirë përdorimin e internetit për të përhapur ideologjitë e tyre radikale dhe për të gjetur mbështetës për kauzën e tyre ⁽¹⁾.

Kjo punëtori e ekspertëve në shkallë të vogël e RNR në BP i mbledhi së bashku ekspertët dhe praktikuesit e parandalimit dhe kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH) nga BP dhe BE, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile (OSHC), të rinjtë dhe punonjësit socialë, mësimmshënësit dhe profesionistët e arsimit, zyrtarët e policisë dhe ekspertët e medias dhe të komunikimit, të cilët diskutuan për sfidat dhe mësimet e nxjerra në lidhje me kuptimin dhe trajtimin e radikalizimit online. Fokusi i takimit ishte në të kuptuarit e narrativave ekstremiste në internet, aktorëve, kanaleve të shpërndarjes dhe grupeve të cenueshme, dhe si praktikuesit mund të adresojnë radikalizimin në internet si nëpërmjet punës digjitale ashtu edhe jashtë internetit në lidhje me P/KEDH. Disa nga gjetjet kryesore të takimit janë renditur më poshtë.

- **Ideologjitë ekstremiste nuk janë të kufizuara vetëm në ndikimin në nivel të vendit.** Përkundrazi, propaganda ekstremiste në internet në BP bazohet në narrativa rajonale dhe (nganjëherë) ndërkombëtare. Më tej, ata i shfrytëzojnë lidhjet rajonale të bazuara në një urrejtje të caktuar, konspiracion ose ekstrem, identitet gjuhësor ose etnik, që përhapet në të gjithë rajonin. Për më tepër, qasjet online ndaj P/KEDH janë ende të reja në rajon dhe kryesisht fokusohen në fushatat e narrative alternative.
- **BP është shumë i ndjeshëm ndaj përhapjes së narrativave konspirative, dezinformative dhe lajmeve të rreme,** lidhur me pandeminë e KOVID-19 dhe pushtimin e fundit rus të Ukrainës. Ekziston një frikë në rritje se rekrutimi online i ekstremistëve të djathtë mund të rezultojë në bashkimin e luftëtarëve të huaj me Rusinë në pushtimin e Ukrainës.
- **Rajoni i Ballkanit Perëndimor është ende i ndikuar nga pasojat e konflikteve të fundit.** Narrativat e urrejtjes në internet të përhapura nga grupet ekstremiste i përforcojnë dallimet etnike dhe e shtojnë polarizimin ndëretnik. Ata i kanë forcuar ndarjet shoqërore përgjatë linjave ekonomike dhe politike. Më tej, paqëndrueshmëritë politike dhe polarizimi i vazhdueshëm janë pjesërisht një trashëgimi e konflikteve

⁽¹⁾ Dukić, S. (2021). *Ekstremizmi online në Maqedoninë e Veriut – Politika, etnitë dhe feja*. Rrjeti i Qyteteve të Forta, Instituti për Dialog Strategjik.

të mëparshme. Si rezultat i mjeteve të pamjaftueshme për t'u përballur me të kaluarën dhe për të arritur pajtimin, hapësira online u bë një teatër për këto konflikte të vazhdueshme.

- **Ka një kërcënim sigurie në rritje për ngritjen e ekstremizmit etnonacional dhe të ekstremit të djathtë**, si dhe të radikalizimit reciprok të shkaktuar nga polarizimi, revizionizmi historik dhe narrativat politike. Mjedisi ekstremist po evoluon dhe vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet identifikimit të narrativave të shumta ekstremiste që nxisin armiqësinë, urrejtjen dhe dhunën ndëretnike.
- Me një bollëk të **ueb-faqeve të huaja** që përhapin informacione në gjuhët lokale dhe me rritjen e ndjeshme të pranisë së tyre në internet në BP, **influcues ekstremistë ndërkombëtarë** — si islamikë ashtu edhe të djathtë ekstremë — nga jashtë rajoni, e përdorin internetin për të arritur tek audiencia e atjeshme. Narrativat ekstremiste unike rajonale që i shfrytëzojnë ankesat historike gjithashtu paraqiten në shkallë globale përmes mjedisit online.
- **Gjinia** është një pjesë e rëndësishme e narrativave ekstremiste. Ekstremistët e keqpërdorin "tradicionalizmin" dhe "familjen" në hapësirën online jo vetëm për - pak a shumë - stigmatizim urrejtës dhe shtypje, por edhe për rekrutimin e burrave dhe grave.

Ky punim i paraqet pikat kryesore të diskutimit të mbajtur online gjatë takimit si dhe rekomandimet përkatëse për iniciativat e suksesshme online të P/KEDH.

Çështjet kyçe të diskutimit

Qëllimi i punëtorisë ishte të kontribuonte për një kuptim më të mirë midis praktikuesve të zhvillimeve dhe tendencave kryesore në radikalizimin online dhe implikimet e tij për punën e P/KEDH. Punëtorja u fokusua në narrativat, strategjitë e rekrutimit dhe dallimet brenda procesit të radikalizimit në lidhje me ideologjitë e ndryshme (ekstremizmi i dhunshëm i kraut të djathtë dhe ekstremizmi i dhunshëm islamik) dhe grupet e synuara.

Roli i historisë dhe konteksti gjeopolitik i ekstremizmit online në Ballkanin Perëndimor

Ekstremizmi online në BP është shumë i lidhur me demografinë dhe historinë e veçantë të rajonit. Ideologjitë ekstremiste nuk janë të kufizuara vetëm në ndikimin në nivel të vendit. Në vend të kësaj, mesazhet e ekstremistëve të BP-së në internet varen nga dhe i shfrytëzojnë mitet dhe demografinë historike etnonacionaliste rajonale. Ideologjitë ekstremiste të përhapura në BP kanë ndjekës të konsiderueshëm online, të cilët janë të kufizuar në kufijtë politikë, gjuhësorë dhe etnikë. Narrativat e tilla ekstremiste të rajonalizuara janë të lidhura në mënyrë të pandashme me historinë e dhunës dhe grindjet e vazhdueshme ndëretnike në rajon. Për më tepër, këto tregime shfrytëzohen ndërkombëtarisht dhe një nga ata shembuj ishte rasti i Brenton Tarrant-it i cili kreu një sulm terrorist në vendet e adhurimit mysliman në Christchurch, Zelanda e Re. Gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë të sulmit të tij, në sfond ishte lëshuar një këngë nacionaliste serbe me rrënjë në luftërat jugosllave dhe që i referohej dhe i përgjigjej kolonializmit historik të Ballkanit. Kënga, e titulluar fillimisht "[Radovan] Karaxhiq [autor i dënuar për mizori], Udhëhiq serbët e tu", e titulluar ndryshe si "Serbia e fortë" ose "Hiq qebapin", tani është një himn midis grupeve ekstremiste të kraut të djathtë ndërkombëtar. Ekstremistët e kraut të djathtë janë mbërthyer në hapësirën online me idenë se Ballkani është hapësirë e *Antemurale Christianitatis* (rajoni që i mbron kufijtë e krishterizmit). Ndërkombëtarizimi i ekstremizmit të kraut të djathtë nuk është kryesisht një çështje e ndërveprimit fizik, por ndodh në internet dhe BP është një frymëzim për shumë ekstremistë.

Përmbajtja islamiste në mënyrë eksplicite ekstremiste dhe urrejtëse është gjithashtu e pranishme dhe shpërndahet përmes grupeve të ndryshme. Narrativat ekstremiste islamike janë gjithashtu në shënjestër të popullsisë së BP. IslamHouse, një ueb-faqe e shquar me bazë në Gjirin Persik që hoston përmbajtje nga një numër klerikësh ekstremistë islamikë, hoston përmbajtje edhe në gjuhët e BP. Në mediat sociale kryesore, pjesa më e madhe e përmbajtjes në internet të grupeve dhe ndikuesve islamikë nga BP-ja është jo e dhunshme, por edhe kur ideologjia ekstremiste nuk promovon drejtpërdrejt terrorizmin dhe dhunën, ajo mund të krijojë ndarje të rrezikshme në shoqëri që minojnë sistematikisht vlerat dhe institucionet demokratike. Kjo retorikë përbën një kërcënim të veçantë për përpjekjet që zgjasin me dekada për të arritur paqe të qëndrueshme dhe barazi gjinore

në BP. Në të vërtetë, ky lloj radikalizimi më delikat është gati të prodhojë sfida të rëndësishme afatgjata sociale, politike dhe të sigurisë.

Shfrytëzimi i pandemisë dhe i luftës në Ukrainë nëpërmjet aktorëve ekstremistë të krahut të djathtë

Ashtu si edhe vendet e tjera në botë, grupet terroriste dhe të dhunshme ekstremiste kanë shfrytëzuar me sukses dobësitë në mediat sociale në BP për të manipuluar njerëzit dhe për të shpërndarë teori konspirative. Këto tendenca janë përkeqësuar më tej nga pandemia e KOVID-19, si dhe nga pushtimi rus i Ukrainës. Madje edhe para pandemisë, kishte pasur një normalizim të diskursit ekstremist në BP dhe një përhapje të narrativave ekstremiste në mediat kryesore sociale (gjegjësisht Facebook, YouTube, Twitter, Instagram, TikTok, "trolling" (shqetësim përmes postimit provokues online) në seksionet e komenteve të përmbajtjeve të mediave informative). Megjithatë këto narrativa janë më të arritshme për të rinjtë, ato mund të jenë bërë edhe më tërheqëse kur filloi pandemia e KOVID-19. Ato janë potencialisht më të dëmshme pasi hapësira "pafund" e internetit është një burim i rëndësishëm për informim dhe për formimin kognitiv të gjeneratave të reja. Nëse nuk bëhet asgjë në drejtim të kontrollit efektiv të përmbajtjeve, ndërtimit të kundër-narrativave dhe parandalimit të radikalizimit, kjo mund të paraqesë një rrezik të rëndësishëm për arkitekturën e paqes së paqëndrueshme në BP.

Grupet ekstremiste të ekstremit të djathtë në internet përdorin tema globale dhe i shfrytëzojnë ankesat rajonale dhe lokale për të rekrutuar më shumë ndjekës. Shumë nga këto tema globale i pasqyrojnë ndjenjat e grupeve ndërkombëtare të krahut të djathtë dhe për këtë arsye promovojnë narrativa të anti-globalizimit ose e krentojnë forcimin e "populizmit" në Perëndim. Për shembull, teoritë konspirative të lidhura me vaksinimin dhe pandeminë, diskursi anti-gjinor/anti-feminist, retorika kundër imigracionit dhe mbështetja e pushtimit rus të Ukrainës janë shfaqur dukshëm në përmbajtjet në internet të grupeve të ekstremit të djathtë në BP ⁽²⁾. Këto tema shfrytëzohen për të forcuar më shumë ndjenjën kundër establishmentit, dhe në disa raste për të ngritur vlerën që ndjekësit ia japin "luftës" globale kundrejt asaj kombëtare. Thënë shkurt, demokracia apo përpjekja për vlera demokratike shihet se është kërcënuar. Pushtimi aktual i Ukrainës portretizohet si beteja përfundimtare për pronësinë e rendit global - globalizmi demokratik kundrejt nacionalizmit totalitar (klerikal). Grupet e krahut të djathtë në internet kanë zhvilluar një ndikim të gjerë shumë shpejt gjatë pandemisë dhe pushtimit të Ukrainës. Disa madje kanë qenë vendimtare për krijimin e skenës për formimin e një brezi të ri politikanësh në BP. Tani ekziston rreziku që një brez i ri politikanësh konservativë në BP të ndjekë diskursin e anti-globalizmit dhe etnonacionalizmit.

Integrimi i narrativave ekstremiste përmes mediave sociale dhe punës humanitare

"Klima" që e karakterizon BP-në është varfëria e përhapur socio-ekonomike, manipulimi elitari i traumave kolektive për të promovuar "tjetërsinë" (d.m.th. dehumanizimi/zhvlerësimi i grupeve të tjera) dhe defetizmi midis qytetarëve, të shkaktuar nga një ndjenjë e padrejtësisë së përjetshme sociale. E kombinuar me një mosbesim të përgjithshëm ndaj institucioneve dhe sundimit të ligjit, kjo krijoi një terren pjellor që grupe të ndryshme ekstremiste të lulëzojnë në internet. Duke përfutur nga dobësitë strukturore dhe financiare të shtetit dhe komuniteteve lokale, këto grupe po prezantohen si "humanitare". Kjo agjendë përdoret për të tërhequr një numër më të madh anëtarësh, veçanërisht të rinj, dhe për të normalizuar aktivitetet e tyre - jashtë punës humanitare - në komunitetet lokale dhe më gjerë.

Grupet e krahut të djathtë e ndërtojnë pamjen e tyre mbi maskulinitetin toksik dhe pamjen e "djemve të rrezikshëm" që e shohin veten si bajraktarë në kohë fatkeqësish individuale ose kolektive, duke i shfrytëzuar dobësitë e njerëzve që kanë nevojë për ndihmë. Nga ana tjetër, grupet islamike në internet e ndërtojnë praninë e tyre në mikromenaxhimin e jetës së përditshme, duke përfshirë stilin e jetesës, fenë, punën dhe marrëdhëniet martesore - duke i vendosur gjithmonë gratë në rolet e tyre tradicionale. Të dyja janë ofruese të shpeshta të paketave ushqimore dhe ndihmave humanitare për ata që kanë nevojë. Kështu, veprimet online të të gjitha grupeve ekstremiste që lidhen me veprimet fizike shpjegohen më së miri si: "nga 'populli' për 'popullin'". Empatia që ata e shfaqin nxitet nga interesi, por edhe në mënyrë ekskluzive për anëtarët e grupit. Ata janë përpjekur ta portretizojnë veten si shoqata legjitime kulturore ose arsimore ose organizata të komunitetit dhe i kanë përdorur postimet në mediat sociale në lidhje me "punën e tyre humanitare" ose aktivitetet kombëtare klerike (p.sh. mbrojtja e anëtarëve të grupit, vendeve të adhurimit, etj.) për të tërhequr ndjekësit në hapësirat online.

(2) Veljan, N., & Čehajić Čampara, M. (2021). *Gender ideologies: How extremists exploit battles over women's rights and drive reciprocal radicalization*. Atlantic Initiative. <https://atlanticinitiative.org/gender-ideologies-how-extremists-exploit-battles-over-womens-rights-and-drive-reciprocal-radicalization/>

Grupet ekstremiste kanë potencialin të përshtaten me situata të ndryshme për të tërhequr më shumë ndjekës dhe për të promovuar një agjendë që mund të çojë në radikalizim në hapësirën online. Gjithashtu, grupet islamike kanë filluar të përdorin gjuhë që nuk thërret për dhunë – kështu që përmbajtja e tyre më shpesh nuk shihet si kërcënim për sigurinë. Megjithatë, ato ende paraqesin rrezik sepse i komentojnë çështjet mbizotëruese sociale dhe politike përmes një lente të ngurtë konservatore dhe kjo kërkon trajnime shtesë të palëve të interesuara për të njohur fytyrën në ndryshim të narrativave ekstremiste jo të dhunshme. Pakicat etnike dhe gjinore janë shumë shpesh të sulmuara dhe ndikimi ekstremist në internet përmes dehumanizimit — "Tjetërsimit" - krijon një mjedis ku përdorimi i dhunës bëhet i pranueshëm. Kundër-narrativat janë inekzistente ose margjinale dhe zakonisht kanë një shtrirje të dobët që nuk synon në mënyrë specifike individët në rrezik të radikalizimit, por kryesisht publikun e gjerë.

Rëndësia e arsimit dhe edukimit mediatic në krijimin e qëndrueshmërisë

BP është shumë i ndjeshëm ndaj dezinformimit, i cili ndikon në radikalizimin, për shkak të niveleve të ulëta të edukimit mediatic. Instituti i Shoqërisë së Hapur – Indeksi i Edukimit Mediatic i Sofjes 2021 i vendosi vendet e Ballkanit Perëndimor në fund të renditjes së tij dhe deklaroi se kapacitetet e ulëta për t'u marrë me dezinformimin shkaktohen nga "niveli i dobët" i njohurive për sa i përket lirisë së mediave dhe arsimit" (3). Një pjesë e problemit është numri i konsiderueshëm i kanaleve mediatike të cilave u mungon transparencja në lidhje me informacionin mbi pronësinë. Shumica e përmbajtjeve të rreme ose mashtruese të medias janë të natyrës politike dhe shërbejnë për të mundësuar radikalizimin. Fushatat e dezinformimit shpesh zhvillohen në mënyrë rajonale dhe reciproke, duke nxitur nacionalizmin dhe polarizimin midis vendeve fqinje. Edukimi mediatic është në një nivel kritik të ulët për të gjitha gjeneratat në mbarë BP. Mungesa e vlerësimit kritik të përmbajtjeve në internet dhe pamundësia e të menduarit kritik për identitetin, fenë, gjininë, historinë dhe politikën në hapësirën online kanë qenë në thelb të cenueshmërisë në radikalizimin në internet (4). Prindërit dhe plan-programet shkollorë nuk mund të mbajnë hapin me trendet e internetit ose ndikimin e tyre në zhvillimin kognitiv, emocional dhe të sjelljes të të rinjve. Efektet ndërmjet gjeneratave janë nënvlerësuar në përgjithësi dhe veçanërisht kur merret parasysh ndikimi i internetit në zhvillimin e të rinjve (5).

Një nga pasojat më shkatërruese në konfliktet e fundit në BP-së është institucionalizimi i dallimeve etnike në sistemin e arsimit. Mjedisi pas konfliktit dhe post-totalitar i brezave të rinj në BP do të thotë se ata po rriten në izolim etnik, traumat kolektive janë të përhapura dhe ata e përjetojnë gjendjen e "ekstremizmit si normale" në jetën e përditshme, veçanërisht në hapësirën online. Si të tilla, këto gjenerata janë më të ndjeshme ndaj radikalizimit. Sistemet arsimore në të gjithë BP vazhdojnë të karakterizohen nga metoda dhe teknika të vjetruara të mësimdhënies të bazuara në leksionet "ex cathedra" të përqendruara te instruktorët, që e favorizojnë memorizimin e fakteve, gjë që çon në mungesën e mendimit kritik dhe aftësive analitike. Disa autorë kanë vënë në dukje se këto mangësi të sistemit arsimor kontribuojnë në tjetërsimin dhe radikalizimin e të rinjve, duke i bërë ata të jenë më të pranueshëm dhe më të prekshëm ndaj mesazheve të dëmshme (online) (6). Duke pasur parasysh rritjen e kohës që të rinjtë e kalojnë në internet gjatë mbylljeve për shkak të KOVID-19, nuk është për t'u habitur që dezinformatat, teoritë e konspiracionit dhe dezinformatat në mediat sociale janë përforcuar gjatë kësaj periudhe.

Rekomandime

Kjo punëtori identifikoi disa boshllëqe në praktikën e praktikuesve të BP-së kur bëhet fjalë për parandalimin e radikalizimit online. Së pari, fokusi në parandalim është shumë i ulët dhe shumica e aktiviteteve reduktohen në

(3) Indeksi i Edukimit Mediatic është krijuar nga Iniciativa e Politikave Evropiane të Institutit të Shoqërisë së Hapur – Sofje. Shih: <https://osis.bq/?p=3750&lang=en>

(4) Shih, për shembull: Halilović, M., Zuković, A., & Veljan, N. (2019). *Mapping online extremism in Bosnia and Herzegovina: Findings and reflections*. Atlantic Initiative.

(5) Buljubašić, M., & Holá, B. (2021). Historical trauma and radicalisation: How can intergenerational transmission of collective traumas contribute to (group) radicalisation? Atlantic Initiative. Shih: <https://atlanticinitiative.org/wp-content/uploads/2021/10/Policy-Paper-Br.-2-ENG.pdf>

(6) Perry, V. (2015). *Countering the cultivation of extremism in Bosnia and Herzegovina: The case for comprehensive education reform*. Këshilli i Politikave të Demokratizimit (KPC). Shih: https://www.academia.edu/15969761/Countering_the_Cultivation_of_Extremism_in_Bosnia_and_Herzegovina_The_Case_for_Comprehensive_Education_Reform

reagimet e institucioneve (ndjekja pas ngjarjeve), ndërsa ndërgjegjësimi i praktikuesve për ekstremizmin e djathtë (të dhunshëm) është gjithashtu shumë i ulët. Më poshtë janë dhënë disa rekomandime që u diskutuan gjatë takimit.

1) Bashkëpunimi dhe komunikimi rajonal dhe ndërkombëtar

Radikalizimi online nuk është një kërcënim që mund të trajtohet nga shtetet thjesht në nivel kombëtar – natyra e tij transnacionale e potencon nevojën për një strategji më të gjerë që do të përfshijë si BE-në ashtu edhe BP-në. Ekziston nevoja për të krijuar korniza rajonale dhe ndërkombëtare dhe për të forcuar bashkëpunimin midis praktikuesve, ekspertëve, institucioneve dhe politikëbërësve, në mënyrë që të zvogëlohen boshllëqet midis aktiviteteve online të BE-së dhe BP-së për sa i përket P/KEDH.

2) "Qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë" dhe bashkëpunimi kombëtar ndërmjet institucioneve qeveritare dhe OSHC-ve

Strategjitë kundër terrorizmit të P/KEDH duhet ta njohin dhe ta përfshijnë kërcënimin e radikalizimit në internet. Qasjet specifike, nëse është e mundur, të koordinuara rajonalisht, duhet të merren jo vetëm me gjuhën e urrejtjes, por edhe me mohimin e mizorive, revizionizmin historik, ekstremizmin, dezinformimin dhe lajmet e rreme.

Bota online po evoluon vazhdimisht dhe duhet të ketë një punëtori të specializuar që synon palët e interesuara për të stimuluar miratimin e masave të përshtatshme dhe në kohë dhe për të vendosur synime strategjike në lidhje me radikalizimin online. Kjo përfshin gjithashtu nevojën që politikëbërësit, ekspertët dhe praktikantët të bashkëpunojnë dhe të gjejnë një hapësirë për diskutim të hapur dhe për të hartuar qasje të ndryshme, duke u bazuar në praktikën e mëparshme përtej BP-së, dhe për të shpikur praktika të reja të adaptueshme për kontekstin e BP-së.

3) Transferimi dhe zgjerimi i dialogut dhe i bashkëpunimit ndërfetar në sferën online

Aktivitetet e P/KEDH duhet të përfshijnë ose të lidhen me dialogun ndërfetar. Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve fetare duhet të jetë i arritshëm për kategori të ndryshme shoqërore në mbarë BP. Zërat e moderuar fetarë duhet të përforcohen dhe të jenë lehtësisht të qasshëm për të rinjtë në media të ndryshme sociale. Të organizohen ligjëratat dhe pjesëmarrësve t'u jepet mundësia të bëjnë pyetje gjatë këtyre ligjëratave për të nxitur diskutimin dhe reflektimin.

4) Përfshirja gjinore e aktiviteteve P/KEDH online dhe offline

Prania digjitale ekstremiste në internet është me ngjyrim të theksuar gjinor, me burra dhe gra që marrin pjesë në mënyra të ndryshme. Është e rëndësishme të fitohet një kuptim më i thellë i nocioneve të gjinisë, maskulinitetit dhe feminitetit dhe se si këto përdoren dhe instrumentalizohen në thirrjet për dhunë terroriste.

Ekziston nevoja për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve qeveritare për të zhvilluar udhëzime mbi gjininë dhe ekstremizmin e dhunshëm për një sërë palësh të interesuara. Udhëzimet mund ta trajtojnë dhunën kundër grave, lëvizjet kundër barazisë gjinore dhe radikalizimin në internet ku mbivendosen njëra me tjetrën mizogjinia dhe ekstremizmi i dhunshëm.

5) Ngritja e kapaciteteve të praktikuesve

Ka një mungesë ekspertize, mungesë qasjesh strategjike në trajtimin e radikalizimit në internet dhe mungesë të koordinimit dhe bashkëpunim të pamjaftueshëm ndërmjet palëve të interesuara. Nevojitet sigurimi i ngritjes së kapaciteteve për praktikuesit mbi kërcënimet ekstremiste në internet. Punonjësit socialë, edukatorët, stafi i sigurisë, etj., mundësisht ata që punojnë me komunitetet e cënueshme, duhet të jenë në gjendje të njohin dhe të merren me treguesit e ekstremizmit dhe të trajtojnë bashkëpunëtorët.

Mësuesit dhe punonjësit me të rinjtë duhet të kenë të paktën njohuri bazë për platformat përkatëse dhe narrativat dhe si mediat sociale dhe lajmet e rreme ndikojnë në radikalizimin në internet. Një punëtori mund të drejtohet nga ekspertë të mediave sociale dhe të ekstremizmit të dhunshëm për të dhënë informacion mbi aspektet kryesore.

Praktikat përkatëse

1. Organizata "[Zashto ne](#)"("Pse jo") (BdheH) është një shembull i shkëlqyer se si trajtohen narrativat ekstremiste, etnonacionaliste nëpërmjet verifikimit të fakteve. Nëpërmjet verifikimit të fakteve ata i zbërthejnë teoritë e konspiracionit, revizionizmin historik, dezinformatat dhe lajmet e rreme, duke promovuar kështu llogaridhënien në mbarë BP.
2. Iniciativa [Qytetarët kundër terrorizmit në Bosnjë dhe Hercegovinë \(CAT BiH\)](#) është grupi i parë rinor që i përqafoi format e njohura të internetit si memet, vloget dhe podkastet në BdheH dhe i përdori ato për iniciativat në lidhje me P/KEDH. Përveç edukimit dhe programeve për të rinjtë, pjesa më e madhe e angazhimit të tyre online fokusohet në reagimet ndaj akteve dhe narrativave ekstremiste. Ky projekt zbatohet nga [Qendra e Burimeve Rinore nga Tuzla](#).
3. #NukËshtëAshtuSiçDuket (#NijetoBasTakto) është një fushatë nga [Iniciativa e Zërave Rezonant](#) (SR). Në këtë fushatë janë ndarë përvojat personale të migrantëve në diasporë nga BP dhe si mund të lidhen ato me përvojat e atyre që sapo kanë ardhur në Evropë. Deri më tani iniciativa: (1) ka zhvilluar dhe angazhuar përdorues online; (2) ka ofruar narrativa alternative; dhe (3) ka adresuar një grup të synuar të përcaktuar që konsiderohet i ndjeshëm ndaj radikalizimit në internet.
4. Njësia e Referimit në Internet e Europolit (IRU) punon në aktivitete të ndryshme për të trajtuar përhapjen e përmbajtjeve terroriste në internet. IRU punon në: (1) analizën strategjike; (2) monitorimin e propagandës terroriste në internet; (3) përgatitjen e raporteve për Shtetet Anëtare dhe palët e treta; (4) raportet e situatës (p.sh. për shfrytëzimin e grave dhe fëmijëve); dhe (5) [Raportin e situatës dhe të tendencave të terrorizmit në BE](#). Më tej, ata kanë zhvilluar një mekanizëm referimi me synimin për të hequr përmbajtjen në internet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Aktivitetet e mëtejshme

Sa u përket rekomandimeve të mësipërme, duhet të organizohen takime të mëtejshme për të diskutuar mekanizmat online të P/KEDH-së për bashkëpunimin rajonal të ekspertëve, praktikuesve dhe politikëbërësve në BP. Çdo takim i ardhshëm duhet të përfshijë një fokus në ekstremizmin jo të dhunshëm në internet dhe influencat e krahut të djathtë në internet.

Materiale për lexim

Azinović, V. (2018). *Regional report: Understanding violent extremism in the Western Balkans*. British Council Extremism Research Forum.
https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf

Dukić, S. (2021). *Online extremism in North Macedonia – Politics, ethnicities and religion*. Strong Cities Network, Institute for Strategic Dialogue. <https://www.isdglobal.org/isd-publications/online-extremism-in-north-macedonia-politics-ethnicities-and-religion/>

Halilović, M., Zuković, A., & Veljan, N. (2019). *Mapping online extremism in Bosnia and Herzegovina: Findings & reflections*. Atlantic Initiative. <https://atlantskainicijativa.org/wp-content/uploads/mapping-online-extremism-in-Bosnia-and-Herzegovina-findings-and-reflections-atlantic-initiative-atlantska-inicijativ.pdf>

RAN LOCAL. (2021). *An online P/CVE approach for local authorities: Challenges, tips & tricks*. Online meeting, 27-28 May. https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/publications/ran-local-online-pcve-approach-local-authorities-challenges-tips-tricks-online-meeting-27-28-may_en

Scheuble, S., & Oezmen, F. (2022). *Extremists' targeting of young women on social media and lessons for P/CVE*. Radicalisation Awareness Network. https://home-affairs.ec.europa.eu/whats-new/publications/extremists-targeting-young-women-social-media-and-lessons-pcve-february-2022_en